



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr.1541, datë 04.04.2011

Për

“Shqyrtimin e Ankimit Administrative të Vodafone Albania sh.a. për Vendimet Nr.1505, Nr.1507 dhe Nr.1508, datë 10.02.2011 të KD të AKEP”

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Znj. Alketa	Mukavelati	Anëtar
3. Z. Benon	Paloka	Anëtar
4. Z. Ibsen	Elezi	Anëtar
5. Znj. Zamira	Nurçe	Anëtar

dhe sekretare Znj.Marsida Drushku, në mbledhjen e datës 04.04.2011, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 8480, datë 27. 05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe Rregullores së Brendshme të AKEP-it, shqyrtoi çështjen me objekt:

“Shqyrtimin e Ankimit Administrative të Vodafone Albania sh.a. për Vendimet Nr.1505, Nr.1507 dhe Nr.1508, datë 10.02.2011 të KD të AKEP”

Dokumentacioni i Grupit të Punës të ngritur me Urdhërin e Brendshëm nr. 639, datë 15.11.2010, përbëhet nga:

- Projekt vendimi;
- Relacioni Shoqërues i projekt vendimit;

BAZA LIGJORE:

1. Neni 8, neni 53, 55, 56, 57, 58 dhe 59 i ligjit nr. 9918, datë 19. 05. 2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (**ligji nr. 9918**);

Adresa: Rr. “Reshit Çollaku”, Nr. 43, Tiranë

Tel : + 355 4 2259 571

Fax : + 355 4 2259 106

www.akep.al

info@akep.al

2. Pika 17 e nenit 21 të “Rregullores së Brendëshme të AKEP (*Rregullorja e Brendshme*), miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të ERT-së, Nr. 170, datë 24.04. 2004, e ndryshuar dhe në fuqi sipas pikës 3 të nenit 138 të ligjit nr. 9918;
3. Vendimi i Këshillit Drejtues të AKEP Nr. 1211, datë 31.03.2010, i ndryshuar;
4. Vendimi i Këshillit Drejtues të AKEP nr.1505, datë 10.02.2011 Për “Miratimin e Dokumentacionit Final: Orientimi në kosto i tarifave të shërbimeve të operatorëve celularë me FNT”;
5. Vendimi i Këshillit Drejtues të AKEP nr.1506, datë 10.02.2011 Për “Miratimin e metodologjive të rregullimit për orientimin në kosto të tarifave të terminimit dhe origjinimit të thirrjeve në rrjetin publik telefonik të lëvizshëm të sipërmarrësit **Albanian Mobile Communications sh.a**”;
6. Vendimi i Këshillit Drejtues të AKEP nr.1507, datë 10.02.2011 Për “Miratimin e metodologjive të rregullimit për orientimin në kosto të tarifave të terminimit dhe origjinimit të thirrjeve në rrjetin publik telefonik të lëvizshëm të sipërmarrësit Vodafone Albania sh.a”;
7. Vendimi i Këshillit Drejtues të AKEP nr.1508, datë 10.02.2011 Për “Miratimin e metodologjisë së rregullimit për orientimin në kosto të tarifës së terminimit të thirrjeve në rrjetin publik telefonik të lëvizshëm të sipërmarrësit Eagle Mobile sh.a”;

K Ë S H I L L I D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

1. Ankimi Administrativ i Vodafone Albania sh.a dërguar me shkresën me Referencë CEO/026/E.Xh, datë 09.03.2011;
2. Shkresë e Vodafone Albania datë 24.03.2011 “Plotësim ankimi” (AKEP: nr. 293/15 prot, datë 24.03.2011), bashkëlidhur dhe korrespondenca me e-mail midis Vodafone dhe Plus Communication;
3. Projektvendim i KD të AKEP “Shqyrtimin e Ankimit Administrative të Vodafone Albania sh.a. për Vendimet Nr.1505, Nr.1507 dhe Nr.1508, datë 10.02.2011 të KD të AKEP”
4. Relacioni shpjegues mbi projektvendimin (*Relacioni*), si dhe,
5. Nga diskutimet në mbledhje mbi çështjen, dhe bazës ligjore të sipërcituar.

V Ë R E N:

1. Vodafone Albania sh.a. nëpërmjet shkresës me Referencë CEO/026/E.Xh, datë 09.03.2011, ka bërë ankim administrativ për Vendimet Nr.1505, Nr.1507 dhe Nr.1508, datë 10.02.2011 të KD të AKEP duke kërkuar:

- Revokimin e pjesshëm të VKD nr.1507 “Për miratimin e metodologjive të rregullimit për orientimin në kosto të tarifave të terminimit dhe origjinimit të thirrjeve në rrjetin publik telefonik të lëvizshëm të sipërmarrësit Vodafone Albania sh.a”;
- Revokimin e pjesshëm të VKD nr.1508 “Për miratimin e metodologjisë së rregullimit për orientimin në kosto të tarifës së terminimit të thirrjeve në rrjetin publik telefonik të lëvizshëm të sipërmarrësit Eagle Mobile sh.a”;
- Revokimin e pjesshëm të VKD nr.1505 “Për Miratimin e Dokumentacionit final: Orientimi në kosto i tarifave të shërbimeve të operatorëve celularë me FNT;

2. Vodafone Albania ka bërë kërkesat e mësipërme duke argumentuar:

1. Vodafone AL kërkesën për revokim të pjesshëm dhe ndryshimin e VKD nr. 1507, përkatësisht pjesa e vlerës së tarifës së terminimit për periudhën 01.03.2011– 31.08.2011, e bazon duke argumentuar se komentet e saj të muajit Korrik 2010 dhe Shkurt 2011 nuk janë marrë parasysh nga AKEP. Vodafone AL konsideron se, AKEP duhet të ndërmarrë një plan më të arsyeshëm të uljes së tarifave të terminimit duke parë edhe një herë propozimin e Vodafone AL në mujin Korrik 2010;
 - Gjithashtu Vodafone AL konsideron se, AKEP edhe nëse nuk miraton propozimin e Vodafone AL, në asnjë mënyrë nuk mund të devijojë nga propozimi i ICC i cili bazohet në gjetjet e rezultatet e modelit të koston;
 - Vodafone AL konstaton se, AKEP dhe ICC kanë arritur të përlllogarisin koston e origjinimit të thirrjeve në rrjetin e Vodafone AL, ndërkoh gjatë mujave të bashkëpunimit nuk është diskutuar kjo çështje;
 - Për sa më sipër Vodafone AL kur ka mungesë totale të këshillimit me operatorët për një rezultat kaq të rëndësishëm të punës së konsulentit Vodafone nuk mund të jetë dakort me rezultatet dhe propozimin konkret të AKEP pasi, nuk është informuar për procesin e llogaritjes së koston në shkelje kjo të neni 58 të Ligjit nr. 9918;
 - Vodafone AL vlerëson se AKEP, nuk ka se si të adoptojë një plan për uljen e përshkallëzuar të tarifave për këtë shërbim sepse kjo do të ishte në kundërshtim edhe me nenet 44, 47, 50, 51 të K.Pr. A;
 - Së fundmi Vodafone AL kërkon që AKEP të revokojë pjesërisht dhe të ndryshojë VKD nr. 1507 për uljen e përshkallëzuar të tarifave të origjinimit duke konstatuar shkelje të rënda procedurale, gjithashtu AKEP të adoptojë minimalisht planin kohor për uljen e përshkallëzuar të propozuar nga konsulenti ICC, si e vetmja gjetje e mbështetur në rezultatet e modelit të koston të përgatitur nga konsulenti;
2. Vodafone AL, kërkesën për revokim të pjesshëm dhe ndryshim të VKD nr. 1508, përkatësisht pjesa e tarifave të terminimit për periudhat Mars 2011-Gusht 2011 dhe Shtator 2011- Gusht 2012 e bazon duke argumentuar se:
 - AKEP me anë të VKD nr. 1508 ka bërë një rishikim të tarifës së terminimit zanor për operatorin Eagle Mobile për periudhën 01.09.2011-01.09.2012 duke e çuar atë në 8.42 lek/min të propozuar në dokumentin e këshillimit publik për tarifën, në vlerën 8.85 lekë/min në VKD nr. 1508 duke vlerësuar se, kjo është një shkelje flagrante e

parimit të mbrojtjes së simetrisë si dhe uljes së konstante të asimetrisë në ato raste përjashtimore kur kjo lejohet;

- Vodafone konsideron se AKEP anashkolon totalisht faktit se tarifa e EM është rritur në raport me tarifën e Vodafone dhe vlerëson se, AKEP pranon që asimetria duhet të vijë në ulje meqënëse kjo është një kërkesë bazë e rekomandimeve të BE-së dhe praktikave më të mira rregullatore por nga ana tjetër AKEP miraton të kundërtën. Gjithashtu thekson se, asimetria mes Eagle Mobile dhe Vodafone AL për fazën 2 (Shtator 2011) është në rritje në krahasim me propozimin sipas dokumentit të këshillimit publik të tarifa;
 - Për sa më sipër Vodafone AL kërkon që AKEP të revokojë pjesërisht VKD nr. 1508 në lidhje me vlerat e tarifave të terminimit për periudhat 01.03.2011-31.08.2011 (10.89 lek/min) dhe 01.09.2011-31.08.2012 (8.85 lek/min) dhe të miratojë vlerën e propozuar nga konsulenti ICC në dokumentin e Rezultateve të Modelit të Tarifave për periudhën 01.03.2011-31.08.2011 (10.31 lek/min) dhe 01.09.2011-31.08.2012 prej 8.42 lek/min;
3. Vodafone AL mbi kërkesën për revokim të pjesshëm të VKD nr. 1505 në lidhje me tarifat e rekomanduara të operatorit Plus, argumenton se:
- AKEP pretendon se nuk mund të rregullojë posaçërisht tarifat e terminimit të operatorit Plus, meqënëse nuk ka një vendim formal për ti dhënë këtij operatori statusin me fuqi të ndjeshme në treg;
 - Për sa më sipër Vodafone AL konsideron se, ky është një justifikim i pa argumentuar nga AKEP dhe se refuzimi i AKEP për të përcaktuar qoftë edhe formalisht statusin me fuqi të ndjeshme në treg për operatorin Plus, tregon se AKEP nuk po kryen detyrën e tij si rregullator në tregun e terminimit. Vodafone vlerëson se AKEP në analizën më të fundit të tregut celular datë 31.03.2011, ka pohuar se të gjithë operatorët e rrjeteve celulare që janë aktive në treg janë përcaktuar si operatorë FNT për terminimin e thirrjeve;
 - Vodafone AL konsideron se, në bazë të neneve 33 dhe 34 të Ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008, dhe në bazë të VKD nr. 1211 Aneksi 1- Analiza e tregut celular (faqet 46 dhe 50), AKEP duhet të marrë menjëherë një vendim formal për ti dhënë këtë status operatorit Plus dhe për të marrë një vendim për njohjen formale të tarifave të terminimit për këtë operator me një vendim të posaçëm;
 - Vodafone AL thekson se, asimetria matet gjithmonë në raport me tarifën më të ulët në treg, pra me tarifën e saj. Në raport me këtë tarifë asimetria e tarifave të rekomanduara të operatorit Plus shkon në rritje në raport me vlerat e përcaktuara në dokumentin për Këshillim Publik të Tarifave;
 - Për sa më sipër Vodafone AL kërkon që, AKEP të revokojë pjesërisht VKD nr. 1505 dhe të adoptojë vlerat dhe kohëzgjatjen e propozuar nga konsulenti ICC uljen e përshkallëzuar të tarifave për Plus sipas Dokumentit të Rezultatit të Modelit në kundërshtim me vlerat dhe kohëzgjatjen e uljes së përshkallëzuar që përcaktohet në VKD nr. 1505 për Plus;

- Vodafone Albania gjithashtu referon se, ka konstatuar shkeljet procedurale në procesin e përcaktimit të tarifave si më poshtë:
 - o Vodafone AL më datë 31.01.2011 ka paraqitur në mënyrë zyrtare komentet e saj mbi shkeljet në procesin e këshillimeve publike për përcaktimin e kostove për shërbimet e përmëndura në VKD nr. 1507, pretendime të cilat qëndrojnë akoma për Vodafone AL duke i konsideruar ato si pjesë të këtij ankimi administrativ. Vodafone konsideron se, AKEP nuk ka dhënë asnjë shpjegim mbi komentet e Vodafone në Aneksin 1 të VKD nr. 1505, me përjashtim të faktit se dokumenti final i rezultatit të modelit do të publikohet nga AKEP në të ardhmen, duke e vlerësuar këtë si një shkelje të procesit të përcaktimit të kostove nga ana e konsulentit ICC;
 - o Vodafone AL vlerëson se nuk mund të merreshin Vendimet nr. 1505, nr. 1507 dhe nr. 1508 pa u përmbyllur njëherë procesi i këshillimit publik mbi rezultatin e modelit të kostove, pasi ky rezultat përbën bazën teknike dhe argumentuese mbi të cilën AKEP mund të marrë Vendimet për të caktuar tarifat;
4. Vodafone AL për sa më sipër bazuar në nenet 45, 53, 55, 56, 57, dhe 58 të Ligjin 9918 datë 19.05.2010, nenet 44, 47, 50, 51, 117, 118, 137, 138.1, 140 të K. Pr. A, si dhe në dokumentin ERG Common Position (ERG 07-83 e datës 28.02.2008), kërkon:
- Revokimin e pjesshëm të VKD nr.1507 “Për miratimin e metodologjive të rregullimit për orientimin në kosto të tarifave të terminimit dhe origjinimit të thirrjeve në rrjetin publik telefonik të lëvizshëm të sipërmarrësit Vodafone Albania sh.a”, për vlerën e tarifës së terminimit për periudhën 01.03.2011-31.08.2011 dhe miratimin e vlerës së propozuar nga konsulenti ICC në Dokumentin e Rezultateve të Modelit (përkatësisht 9.03 lek/min);
 - Revokimin e pjesshëm të VKD nr.1508 “Për Miratimin e metodologjisë së rregullimit për orientimin në kosto të tarifës së terminimit të thirrjeve në rrjetin publik telefonik të lëvizshëm të sipërmarrësit Eagle Mobile sh.a”, në lidhje me vlerat e tarifave të terminimit për periudhat 01.03.2011-31.08.2011 (10.89 lek/min) dhe 01.09.2011-31.08.2012 (8.85 lek/min) dhe të miratojë vlerën e propozuar nga konsulenti ICC në dokumentin e Rezultateve të Modelit për periudhën 01.03.2011-31.08.2011 (10.31 lek/min) dhe 01.09.2011-31.08.2012 (8.42 lek/min);
 - Revokimin e pjesshëm të VKD nr.1505 “Për Miratimin e Dokumentacionit final: Orientimi në kosto i tarifave të shërbimeve të operatorëve celularë me FNT” në lidhje me vlerat dhe kohëzgjatjen e uljes së përshkallëzuar që përcaktohet në VKD nr. 1505 për operatorin Plus dhe miratimin e vlerave dhe kohëzgjatjes të propozuar nga konsulenti ICC për uljen e përshkallëzuar të tarifave për Plus sipas Dokumentit të Rezultatit të Modelit si dhe marrjen e vendimit për shpalljen e operatorit Plus me fuqi të ndjeshme në tregun e terminimit me shumicë në rrjetin përkatës;
3. **Vodafone AL, me shkresën e datës 24.03.2011 “Plotësim Ankimi” (AKEP: nr. 293/15 prot, datë 24.03.2011), bashkëlidhur dhe korrespondenca me e-mail midis palëve, kërkon shpalljen e operatorit Plus Communication me FNT për terminimin në rrjetin përkatës, si dhe detyrimin e Plus për lidhjen e MI me Vodafone AL dhe nxjerrjen e urdhërit përkatës, duke sqaruar se:**

- Plus ka dështuar të kryejë negociata dhe për rrjedhojë të firmosë MI brënda afateve të përcaktuara në nenin 50 të Ligj nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”;
- Vodafone AL konsideron se, Plus ka kundërshtuar haptazi zbatimin VKD nr. 1468, datë 23.12.2010 “Për Miratimi i Ofertës Referencë të Interkoneksionit të Vodafone Albania sh.a”, duke vlerësuar se VKD nr. 1468 për fuqinë ligjore që disponon nuk është objekt negociatash mes palëve, por implementohet i pandryshueshëm në formë dhe përmbajtje;
- Vodafone AL vlerëson se, Plus ka kundërshtuar haptazi zbatimin e VKD nr. 1505 duke mos e njohur si të ligjshme tarifat që AKEP ka miratuar;
- Vodafone AL thekson se, pavarësisht ankimit administrativ të saj ndaj VKD-ve nr. 1507, nr. 1508, nr. 1505 datë 10.02.2011, Vodafone AL ka lidhur MI në zbatim të tarifave të përcaktuara nga AKEP sipas VKD nr. 1505;
- Vodafone konsideron se, Plus me anë të kthimit të përgjigjeve me email të datës 07.03.2011 dhe 17.03.2011 (bashkelidhur) ka refuzuar të njohë dhe të pranojë tarifën prej 15.93 lek/min duke filluar nga data 01.03.2011 deri në 31.08.2011 sipas përcaktimeve të AKEP, njëkohësisht Plus ka refuzuar të njohë përcaktimin e AKEP për mos aplimin e tarifës për thirrje;
- Vodafone thekson se, që nga hyrja në treg e operatorit plus 8.07.2010, sipas VKD nr. 1173 datë 19.02.2010, AKEP nuk ka ndërmarrë asnjë hap në zbatim të nenit 34 të Ligji nr. 9918, apo të analizës së tregut si dhe në shpalljene Plus si OFNT në tregun e terminimit në rrjetin përkatës;
- ***Për sa më sipër Vodafone AL në zbatim të nenit 45, 53, 56,57, 58, dhe 60 të Ligj nr. 9918 “Për komunikime elektronike në Republikën e Shqipërisë”, të neneve 99, 100, 128, 141, 142/1 dhe 146 të Ligj nr. 8485 K.Pr.A, kërkon:***
- Marrjen e Vendimit për shpalljen e operatorit Plus Communication me fuqi të ndjeshme në tregun e terminimit me shumicë në rrjetin përkatës;
- Detyrimin e Plus të lidhë MI me Vodafone AL me tarifë terminimi në rrjetin e Plus prej 15.93 lek/min prej datës 01.03.2011 deri më 31.08.2011 dhe pa aplikuar tarifë për thirrje;
- Nxjerrjen e Urdhërit përkatës;

4. AKEP pasi ka ka shqyrtuar kërkesat dhe argumentat e mësipërme konsideron se:

1. Në lidhje me komentet dhe kërkesën për ndryshimin e vendimit nr.1707, datë 10.02.2011 (tarifat e terminimit dhe origjinimit në rrjetin Vodafone Albania) AKEP sqaron se, ka marrë në konsideratë komentet e Vodafone gjatë konsultimit publik të kryer në muajin Janar 2010 si dhe ato të shprehura për rezultatet finale të modelit në muajin Korrik 2010. AKEP ka bere arsyetimin përkatës për devijimin nga rekomandimi i ICC, i cili për tarifën e terminimit në rrjetin Vodafone (dhe AMC) ndryshon vetëm në fazen e parë me vetëm 2%, ndërsa fazat e tjera janë të njëjta me rekomandimin e ICC. Gjithashtu edhe për çështjen e koston së origjinimit të thirrjeve, AKEP ka dhënë sqarimin përkatës në

dokumentin “Qëndrimi i AKEP per Komentet ne Konsultimin Publik_10.02.2011” të publikuar në seksionin Konsultime të Perfunduara ne www.akep.al ;

2. Në lidhje me kërkesën për ndryshimin e Vendimit nr.1508, datë 10.02.2011 “Miratimin e metodologjisë së rregullimit për orientimin në kosto të tarifës së terminimit të thirrjeve në rrjetin publik telefonik të lëvizshëm të sipërmarrësit Eagle Mobile sh.a”, AKEP ka bërë arsyetimin për ndryshimin e tarifës së terminimit në rrjetin EM ne fazën e parë nga 8.42 lek/minutë i propozuar në konsultim publik në 8.85 lek/minutë në përfundim të konsultimit publik në dokumentat përkatës:

- i. “Orientimi në kosto i tarifave_celulare_Dokumenti Final 10.02.2011”
- ii. “Qëndrimi i AKEP per Komentet ne Konsultimin Publik_10.02.2011”

të publikuar në seksionin Konsultime të Perfunduara ne www.akep.al. Asimetria midis EM dhe Vodafone/AMC vazhdon të jetë në reduktim edhe pas ndryshimit të vlerës së cituar më lartë. Gjithashtu, AKEP nuk gjykon se është e arsyeshme të merret në konsideratë vetëm asimetria e tarifave të dy operatorëve të tjerë ndaj Vodafone/AMC, por edhe asimetria midis këtyre dy operatorëve ka rëndësi, pasi këta operatorë nuk konkurrojnë vetëm me Vodafone/AMC por edhe me njëri-tjetrin. Ndryshimet e kryera nga AKEP pas konsultimit publik sigurojnë që nivelet e asimetrisë midis operatorëve të vijnë gjithnjë në ulje deri në eliminimin e tyre, siç janë edhe praktikrat më të mira rregullatore;

3. Në lidhje me kërkesën për ndryshimin e Vendimit nr.1505, datë 10.02.2011 Për “Miratimin e Dokumentacionit Final: Orientimi në kosto i tarifave të shërbimeve të operatorëve celularë me FNT”, si dhe pretendimet me shkresën e derguar per “Plotësim Ankimi”, AKEP sqaron se, pavaresisht pretendimeve te Vodafone, vendimi per FNT ose jo te Plus Communication per terminimin e thirrjeve, mund të merret vetëm pas kryerjes së procesit të Analizës së tregut dhe procedurës së këshillimit publik sipas përcaktimeve të Ligjit 9918 dhe Rregullores për Analizën e Tregut. Plus Communication ka hyrë në treg (aktiv) me ofrimin e shërbimeve më 27.11.2010 dhe jo më 8.07.2010. Ndërkohë sic është cituar edhe në dokumentin e Anlizës së tregut celular dhe cituar edhe nga Vodafone në ankimim, AKEP ka të drejtë të përdorë procedurën e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve për tarifën e terminimit në Plus Communication. Kjo praktikë është ndjekur tashmë nga AKEP në Korrik-Gusht 2010, dhe Vodafone nuk mund të paragjykojë për mos-veprim nga AKEP në rast mos-marrëveshje me Plus Communication për tarifën e terminimit në rrjetin e këtij operatori. Kërkesa e Vodafone, që AKEP të nxjerrë urdhër për lidhje MI midis Vodafone dhe Plus Communication, mbi bazën e kërkesës së Vodafone me shkresën e datës 24.03.2011 “Plotësim Ankimi” (AKEP: nr. 293/15 prot, datë 24.03.2011), nuk është e argumentuar, pasi AKEP mund të nxjerrë Urdher/Vendim për zgjidhje mos-marrevshje vetëm në përfundim të një procedure administrative për zgjidhje mos-marrevshje. Neëzbatim të përcaktimeve të Ligjit 9918, rregullores “Për procedurat e Zgjidhjes së Mosmarrvëshjeve” dhe rregullores “Për Aksesin dhe interkoneksionin”, Vodafone duhet të depozitojë një kërkesë për zgjidhje mosmarrëveshje me Plus Communication;

5. Argumentat e Vodafone Albania konsiderohen të pamjaftueshme për të bërë ndryshime në nivelin e tarifave të terminimit të thirrjeve dhe origjinimit të thirrjeve në rrjetet

Vodafone Albania, AMC, të terminimit të thirrjeve në rrjetin EM, si dhe përfundimeve të tjera të përcaktuar në dokumentin “Orientimi në kosto i tarifave të shërbimeve të operatorëve celularë me FNT-Dokumenti Final”, i miratuar me VKD nr.1505, datë 10.02.2011, si dhe në vendimet nr.1506, nr.1507 dhe nr.1508, datë 10.02.2011.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Duke marrë në konsideratë rëndësinë e miratimit të këtij vendimi për konkurrencën në treg, sipërmarrësin dhe realizimin e objektivave rregullatore, bazuar në pikën 1 të nenit 114, dhe pikën 1 të nenit 115 të ligjit nr. 9918, si dhe pika 17, neni 21 të Rregullores së Brendëshme të AKEP, e ndryshuar,

V E N D O S:

1. Të rrëzojë kërkesën ankimore të Vodafone Albania, të depozituar me shkresën me Referencë CEO/026/E.Xh, datë 9.03.2011, për *Vendimet Nr.1505, Nr.1507 dhe Nr.1508, datë 10.02.2011 të KD të AKEP.*
2. Ky vendim të publikohet në faqen e internetit www.akep.al.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R I

Piro XHIXHO

ANËTARET E KËSHILLIT DREJTUES:

1. **Alketa MUKAVELATI**
2. **Benon PALOKA**
3. **Ibsen ELEZI**
4. **Zamira NURÇE**